



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË  
KËSHILLIT TË KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE PËR  
VITIN 2020

Prishtinë, qershor 2021

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1	Opinioni i Auditimit.....	3
2	Gjetjet dhe rekomandimet.....	6
3	Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit.....	10
4	Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	12
	Shtojca I: Letër konfirmimi.....	14
	Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit .....	15

Për: z. Isuf Koci, Udhëheqës Ekzekutiv i Sekretariatit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë

Adresa: Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3, 10000 Prishtinë

## 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>1</sup>.

### Opinionin i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë (KKTK) të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup> për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit *‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’*. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

<sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik

<sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar.

**Konkluzioni i auditimit për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të KKTK-së me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KKTK-së kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Udhëheqësi Ekzekutiv është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Udhëheqësi Ekzekutiv është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Bordi i KKTK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore në

përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mospajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së

---

<sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet.

një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.


- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, testet tona kanë treguar se nevojiten përmirësime sa i përket menaxhimit të personelit, pagesave në avans dhe regjistrimit të pasurive, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. (Për detaje shih kapitullin 4)

## 2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2020 ishte 67,156€, prej tyre ishin shpenzuar 67,156€. Kemi testuar 11 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 8,274€.

---

#### Çështja A1 – Parregullsi në avancimin e stafit

**Gjetja** Rregullorja Nr 02/2011 për punë provuese, neni 4, pika 1 përcakton që kandidati i cili kalon me sukses procedurat e rekrutimit, pranohet si nëpunës civil dhe i nënshtrohet punës provuese si në vijim, pika 1.1 nëpunësi civilë të karrierës, i nënshtrohet punës provuese në kohëzgjatje prej 12 muajsh.

Ne kemi vërejtur që KKTK, zyrtarin e personelit i cili ishte në periudhën provuese të punës, pas tre muajve e kishte caktuar ushtrues detyre (UD) në një pozitë më të lartë nga koeficienti 7 në koeficientin 9, edhe pse ishte në periudhë provuese.

Kjo kishte ndodhur për shkak se, ne njësinë ku ishte caktuar UD ishte vetëm zyrtari i caktuar dhe nuk kishte staf tjetër.

**Ndikimi** Caktimi i nëpunësit civil në pozita më të larta gjatë periudhës provuese duke rritur koeficientet e pagës ndikon në pagesa të cilat janë në kundërshtim me aktet ligjore.

**Rekomandimi A1** Kryetari i Bordit të KKTK duhet të siguroj që caktimi i nëpunësve civil në pozita më të larta apo koeficient më të lartë bëhet vetëm pasi të ketë kaluar periudha provuese në pajtim me procedurat e avancimit.

## 2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2020 ishte 60,354€, prej tyre ishin shpenzuar 52,784€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, derivate, udhëtime jashtë vendit, blerje të pajisjeve të IT si dhe shpenzime tjera. Kemi testuar 56 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 38,205€.

---

### Çështja A2- Pagesa 100% në avans për mallra dhe shërbime

**Gjetja** Ligji i Buxhetit Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020, neni 13 Pagesat e paradhënies pika 1, citon që, Organizatat buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në pesëmbëdhjetë për qind (15%) të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetëmijë (10,000) euro, e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur që KKTK kishte paguar komplet vlerën e kontratës për katër muaj për kursin e gjuhës angleze në vlerë 580€, ndërsa vlera mujore ishte 145€. Kontrata ishte nënshkruar me dt 15.10.2020 ndërsa pagesa ishte kryer me dt 23.10.2020.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme që pagesat të mos bëhen në avans 100% të vlerës së kontratës.

**Ndikimi** Pagesat në paradhënie 100% të vlerës përveç që janë në kundërshtim me ligjin e buxhetit, mund të ndikojnë që shërbimet mos të kryhen sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

**Rekomandimi A2** Kryetari i Bordit duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se pagesa e faturave bëhet në përputhje me përqindjet përcaktuara me ligj të buxhetit.



### 2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV është 786€, pasurive jokatitale është 11,747€, si dhe e stoqeve 21,254€. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale si dhe të pajtueshmërisë në vlerë 1,777€.

---

#### Çështja B1 – Mos regjistrimi i pasurive jo kapitale

**Gjetja** Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rreg. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”.

Gjatë testimit të pasurive nën 1,000€, kemi vërejtur që pasuria nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurive i cili ishte i prezantuar apo shpalosur në PFV e vitit 2020. Pasuritë të cilat nuk ishin regjistruar janë:

- Dy “samsung cover for tablet with keyboard for S4” në vlerë prej 240€; dhe
- Firgoriferi Hugo në vlerë 99.90€, i blerë nga petty cash.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur që pasuria të regjistrohej në regjistrin përkatës.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurive në regjistrin e pasurive nën 1,000€ ndikon në prezantimin jo të drejtë dhe nënvlerësimin e vlerës së pasurive në PFV.

**Rekomandimi B1** Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>4</sup>	2020 Shpenzimi	2019 Shpenzimi	2018 Shpenzimi
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>215,405</b>	<b>128,342</b>	<b>120,580</b>	<b>147,264</b>	<b>152,457</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	215,405	128,342	120,580	147,264	152,457

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 87,063€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i rishikimit buxhetor dhe i kursimeve buxhetore, në pajtim me vendimin e Qeverisë Nr.09/50.


Në vitin 2020, KKTK-ja ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 120,580€, me një zvogëlim prej 4% krahasuar me vitin 2019. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

**Tabela 2 – Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimi	2019 Shpenzimi	2018 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>215,405</b>	<b>128,342</b>	<b>120,580</b>	<b>147,264</b>	<b>152,457</b>
Pagat dhe mëditjet	129,262	67,156	67,156	60,913	89,183
Mallrat dhe shërbimet	83,593	60,354	52,784	85,660	62,407
Komunalitë	2,550	832	640	691	867


<sup>4</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Grafiku 1 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike



Grafiku 2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike në vitin 2020

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike në vitin 2020



Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 62,106€. Me rishikim fillimisht ishte rritur për 4,365€, ndërsa pastaj me vendim të Qeverisë ishte zvogëluar për vlerën 66,471€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 23,238€. Me rishikim fillimisht ishte zvogëluar 14,365€, ndërsa me vendim të Qeverisë ishte zvogëluar për 8,873€. Në këtë kategori shpenzimet ishin 87% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për shërbimet komunale krahasuar me atë fillestar ishte zvogëluar për 1,718€ Te kjo kategori buxheti ishte zvogëluar me rishikim 1,145€, ndërsa me vendim të Qeverisë 573€. Shpenzimi i buxhetit ishte 77%.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të KKTK ka rezultuar me një rekomandim kryesor. KKTK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohet rekomandimin e dhënë.

Deri në fund të auditimit për vitin 2020, KKTK nuk kishte zbatuar rekomandimin e vitit të kaluar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimit dhe mënyrën se si është trajtuar ai, shihni Tabelën 3.

**Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari i Këshillit duhet t'i sigurojë të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	KKTK edhe këtë vit nuk kishte arritur që të sigurojë se të gjitha blerjet janë regjistruar në regjistrat përkatës të pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimin.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2020		
1	Paga dhe Mëditje	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë që caktimi i nëpunësve civil në pozita më të larta apo koeficient më të lartë bëhet vetëm pasi të ketë kaluar periudha provuese në pajtim me procedurat e avancimit.		
2	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se pagesa e faturave bëhet në përputhje me përqindjet përcaktuara me ligj të buxhetit.		

3	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.
---	-----------------------------------	---

Nënshkrimet:

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm

Astrit Bllaca, Udhëheqës i Auditimit

Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)

## Shtojca I: Letër konfirmimi



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore**  
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for Cultural Heritage

### LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për:** Zyrën e Kombëtare të Auditimit

**Të nderuar,**

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të (Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore - KKTK), për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

  
Z. Jusuf Koci, Udhëheqës Ekzekutiv  
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore  
Data: 23 qershor 2021, Prishtinë

Prishtinë 10000, Kompleksi Rilindja, Kontejneri Nr.3  
Tel: +383 (0) 38 200 10 939; +383 (0) 38 211 587  
E-mail: [kktk@rks-gov.net](mailto:kktk@rks-gov.net)  
<https://kktk.rks-gov.net>

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>5</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>6</sup>. Ky opinion duhet të veçohet nga opinionin nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërteta, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështje (-t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet - në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose jo i modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo te tillë(a) te mundshëm(me) të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Një keq-deklarim është një ndryshim midis shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një artikulli të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që artikulli të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### *Forma e opinionit*

#### **Opinionin i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, ose janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose e agreguar, që nuk është e barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi ose keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar të transaksioneve nuk është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit (-eve) material (-e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(-ve).

<sup>5</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë poashtu edhe deklaratat e ekzekutimit të buxhetit

<sup>6</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme të auditimit për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material.

Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Ndryshimet e opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në provat e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit të mjaftueshëm për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria, auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit.

Opinionet e modifikuara mund të jenë:

- Të modifikuara (kualifikuara)
- Të kundërta, ose
- Të mohuara

### Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe / ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve është i barabartë ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit që nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit(-eve) material (-e).

### Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve e tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret në kontekstin e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive për të përshkruar efektet e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë në pasqyrat financiare ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë,



nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë prova të mjaftueshme KTKKekuante të auditimit. Efektet të përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare
- b) Nëse kufizohen kështu, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Në lidhje me shpalosjet, janë thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare.

### **Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe e përhapur.

### **Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.